



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 1 tetor 2021

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të  
Paraburgimit**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave:**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**  
Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)<sup>1</sup>, duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim një apel të parashtruar më 15 korrik 2021 nga z. Kadri Veseli (përkatësisht, “Veseli” ose “i akuzuari” dhe “Apeli”),<sup>2</sup> kundër “Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit” (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>3</sup> Më 26 korrik 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj se Apeli duhet të rrëzohet.<sup>4</sup> Veseli bëri të ditur se nuk do të dorëzonte kundërpërgjigje.<sup>5</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, Veseli u arrestua në Kosovë në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>6</sup> në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 19 korrik 2021 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 30 shtator 2021).

<sup>2</sup> F00001, Apel i Mbrojtjes së Veselit ndaj Vendimit KSC-BC-2020-06/F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit), 15 korrik 2021 (konfidencial) (“Apeli”).

<sup>3</sup> F00380/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit, 2 korrik 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 2 korrik 2021) (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>4</sup> F00003, Përgjigje ndaj Apelit të Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit mbi Paraburgimin të korrikut 2021, 26 korrik 2021 (konfidenciale) (“Përgjigjja”), para. 2, 20.

<sup>5</sup> Mesazh elektronik i 30 korrikut 2021 i bashkëmbrojtësit të Veselit drejtuar juristit të lartë i cili ndihmon Panelin e Gjykatës së Apelit.

<sup>6</sup> F00027/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi, 26 nëntor 2020 (versioni origjinal u dorëzua më 26 tetor 2020) (“Vendimi mbi Arrestimin dhe Paraburgimin”); F00027/A03/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Kadri Veselin, 5 nëntor 2020 (versioni origjinal u dorëzua më 26 tetor 2020); F00050, Njoftim i arrestimit të Kadri Veselit sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 20 nëntor 2020), para. 4.

<sup>7</sup> F00026/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020 (versioni origjinal u dorëzua më 26 tetor 2020) (“Vendimi i Konfirmimit”). Aktakuza në fuqi u dorëzua më 4 nëntor 2020; shih F00045/A03, Aktakuza e Redaktuar më tej, 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 5 nëntor 2020).

2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Veselit për lirim të përkohshëm.<sup>8</sup>
3. Më 30 prill 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e Veselit kundër Vendimit të Parë për Paraburgimin.<sup>9</sup>
4. Më 2 korrik 2021, pasi mori parashtrimet e Veselit dhe ZPS-së,<sup>10</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e Kundërshtuar, në të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Veselit me arsyetimin se vazhdon të ekzistojë dyshim i bazuar se Veseli ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të Dhomave të Specializuara.<sup>11</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që Veseli do të arratiset, do të pengojë ecurinë e procedurave të Dhomave të Specializuara ose do të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), ndër të cilët edhe dëshmitarë të mundshëm.<sup>12</sup>
5. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se kushtet e propozuara nga Veseli për lirimin e tij me kusht (“Kushtet e Propozuara”) ose çdo kusht tjetër shtesë i vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, mund të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e arratisjes, por nuk mund të zvogëlonin

---

<sup>8</sup> F00151, Kërkesë për Lirim të Përkohshëm të Kadri Veselit, 17 dhjetor 2020 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 22 janar 2021); F00178, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Lirim të Përkohshëm, 22 janar 2021 (“Vendimi i Parë për Paraburgimin”).

<sup>9</sup> F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (“Vendimi i Apelit të Veselit”).

<sup>10</sup> F00341/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 25 qershor 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 7 qershor 2021) (“Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit”); F00354/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 17 qershor 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 17 qershor 2021) (“Përgjigja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit”); F00365/RED, Version i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së - KSC-BC-2020-06/F00354 (Rishikimi i Paraburgimit) (F00365, datë 22 qershor 2021), 24 qershor 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 22 qershor 2021) (“Kundërpërgjigja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit”).

<sup>11</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 22-29.

<sup>12</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 32-33, 35-37, 39-42.

mjaftueshëm rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave të Dhomave të Specializuara apo rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.<sup>13</sup> Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se paraburgimi i Veselit vijonte të ishte proporcional.<sup>14</sup>

6. Në Apel, Veseli shtjellon katër pika apeli që kanë të bëjnë me pretendime për gabime dhe shpërdorim të kompetencës diskrecionale nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>15</sup> Veseli kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të miratojë Apelin dhe të urdhërojë lirimin e tij të përkohshëm me disa ose të gjitha Kushtet e Propozuara.<sup>16</sup> Ndryshe, Veseli kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit t'ia kthejë çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe ta udhëzojë atë të rishikojë Vendimin e Kundërshtuar pasi të urdhërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës të trajtojë zbatueshmërinë e secilit prej Kushteve të Propozuara të lirimit.<sup>17</sup>

## II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

7. Paneli i Gjykatës së Apelit do të zbatojë standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme, të përcaktuar në vendimin e vet të parë dhe të zbatuar në vendimet e mëpasshme.<sup>18</sup>

---

<sup>13</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46-51.

<sup>14</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 55-56.

<sup>15</sup> Apeli, para. 3 (f. 2-3). Është bërë një gabim në vendosjen e numrave të paragrafëve në fillim të Apelit, pasi numrat e paragrafëve 1-3 përsëriten. Për të shmangur ndonjë ngatërrësë, kur t'i referohet njërit prej këtyre paragrafëve, Paneli do të bëjë të ditur numrin e faqes që gjendet në vulën në pjesën e sipërme majtas të faqes në të cilën ndodhet paragrafi përkatës.

<sup>16</sup> Apeli, para. 14.

<sup>17</sup> Apeli, para. 13, 15.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi i Apelit të Gucatit"), para. 4-14. Shih gjithashtu p.sh. KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021 ("Vendimi i Apelit të Haradinajt"), para. 11-14; Vendimi i Apelit të Veselit, para. 4-7.

### III. ÇËSHTJE PARAPRAKE

#### A. PARASHTRIMET PUBLIKE

8. Paneli thekson se Veseli dhe ZPS-ja ende nuk kanë dorëzuar për protokollim versionet e redaktuara publike të Apelit dhe Përgjigjes. Duke marrë parasysh se të gjitha parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara duhet të jenë publike, përveçse kur ka arsye të posaçme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë për protokollim versione të redaktuara publike të gjitha parashtrimeve jopublike që i paraqesin Panelit,<sup>19</sup> Paneli urdhëron palët që brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim, të dorëzojnë për protokollim versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të lartpërmendura, ose të bëjnë të ditur, nëpërmjet një parashtrimi, nëse ato mund të riklasifikohen si publike.

9. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës së Apelit vë në dukje se detyrimi që parashtrimet e protokolluara të jenë publike sa më shumë që të jetë e mundshme nënkupton automatikisht që ato duhet të bëhen publike (për shembull, në formë të redaktuar) sapo të jetë e mundur. Kjo, jo vetëm që është në respektim të parimit të procesit publik, por ka edhe përparësi praktike, sepse e ndihmon Panelin të vlerësojë, për shembull, se cili informacion brenda një parashtrimi të protokolluar konfidencial duhet të redaktohet në vendimin e Panelit dhe cili mund të bëhet publik. Rrjedhimisht, Paneli u kujton palëve që të dorëzojnë sa më shpejt versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre dhe të mos presin që për këtë t'u japë urdhër Paneli.

#### B. STANDARDI I ZBATUESHËM PËR RISHIKIMIN E PARABURGIMIT

---

<sup>19</sup> Shih p.sh. KSC-BC-2020-07, F00007, Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit për Mocionet Paraprake, 23 qershor 2021, para. 13; F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni original u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Apelit të Thaçit"), para. 10.

10. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton dispozitat e Ligjit dhe të Rregullores që kanë lidhje me rishikimin e paraburgimit.

11. Neni 41(10) i Ligjit parasheh që:

Deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, dy (2) muaj pas aktvendimit të fundit për paraburgimin, gjyqtari i procedurës paraprake ose trupi gjykues i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për paraburgim dhe nxjerr aktvendim për lirimin apo ndërprerjen e paraburgimit. Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktvendimi në Panelin e Gjykatës së Apelit.

12. Rregulla 57(2) e Rregullores thotë:

Pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, dhe deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

13. Në vendimin mbi Apelin e Haradinajt, të cilin Paneli i Gjykatës së Apelit e mori në lidhje me apelin e Haradinajt ndaj vendimit të parë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rishikimin e paraburgimit të tij, Paneli konstatoi se:

Paneli kompetent ka detyrimin të shqyrtojë arsyet ose rrethanat mbi të cilat mbështetet paraburgimi dhe të konstatojë nëse këto arsye vijnë në ekzistencë sipas nenit 41(6) të Ligjit. Panelit kompetent nuk i kërkohet të bëjë konstatime në lidhje me faktorë për të cilët është marrë vendim më parë në vendimin fillestar për paraburgimin, por duhet t'i shqyrtojë këto arsye ose rrethana dhe të përcaktojë nëse ato ekzistojnë ende. Ajo që ka rëndësi thelbësore është që paneli kompetent të bindet se, në kohën e vendimit të rishikimit, ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit.<sup>20</sup>

14. Paneli gjykon se është i nevojshëm një shpjegim i mëtejshëm se si duhet të interpretohen konstatimet e mësipërme. Në lidhje me këtë, Paneli nënvizon se

---

<sup>20</sup> Vendimi i Apelit të Haradinajt, para. 55.

detyrimi për të konstatuar nëse “ekzistojnë ende”<sup>21</sup> rrethanat mbi të cilat mbështetet mbajtja në paraburgim, nuk është i lehtë. Ky detyrim i ngarkon panelit kompetent detyrën që të vlerësojë, *proprio motu*, nëse në momentin e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të rastit në kohën kur bëhet rishikimi, paneli është ende i bindur se mbajtja në paraburgim e të akuzuarit vijon të jetë e përligjur.

15. Paneli mban parasysh se, sipas Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, fraza “ndryshim të rrethanave” në rregullën 57(2) të Rregullores ka të bëjë me rivlerësimin dhe rishikimin e masës së mbajtjes në paraburgim në çdo kohë dhe veçmas nga rishikimi i detyrueshëm çdo dy muaj. Një rivlerësim dhe rishikim i tillë “garanton vlerësimin e faktorëve të rinj të rëndësishëm që mund të paraqiten në periudhën midis dy rivlerësimeve të paraburgimit”.<sup>22</sup> Paneli konstaton se, megjithëse rishikimi që bëhet automatikisht çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk ka të bëjë vetëm me faktin nëse kanë ndryshuar ose jo rrethanat e rastit, një ndryshim i tillë gjithsesi mund të jetë përcaktues dhe duhet të merret parasysh nëse ngrihet para Panelit, ose *proprio motu*.<sup>23</sup>

16. Bazuar në sa më lart, Paneli është bindur se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka zbatuar standardin e duhur.<sup>24</sup> Gjithashtu, Paneli konstaton se nuk duhet të pritët që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të shqyrtojë parashtrime të cilat thjesht përsërisin argumente që tashmë janë trajtuar në vendimet e tij të mëparshme.<sup>25</sup>

---

<sup>21</sup> Shih neni 41(10) i Ligjit: “nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim”.

<sup>22</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 26 maj 2020, para. 67.

<sup>23</sup> Rregulla 57(2) e Rregullores.

<sup>24</sup> Shih Vendimi i Kundërshtuar, para. 16.

<sup>25</sup> Shih p.sh. ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1626-Red, Public Redacted Version of Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 27 June 2011 entitled “Decision on Applications for Provisional Release”, 12 September 2011, para. 60; ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1019, Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 28 July 2010 entitled “Decision on the review of the detention of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo pursuant to Rule 118(2) of the Rules of Procedure and Evidence”, 19 November 2010, para. 53.

#### IV. DISKUTIM

A. MOSZBATIMI I PRETENDUAR I STANDARDIT PROVUES PËR VLERËSIMIN E DYSHIMIT TË BAZUAR SIPAS NENIT 41(6)(A) TË LIGJIT (PIKA I)

##### 1. Parashtrimet e palëve

17. Veseli parashtron se sjellja personale e të akuzuarit është “treguesi më provues i dijenisë kriminale”.<sup>26</sup> Ai argumenton se në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërfilli provat e ZPS-së për pjesëmarrjen e tij personale në kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë dhe në vend të tyre u mbështet në faktorë dytësorë kur konstatoi se ishte vërtetuar natyra e “bazuar mirë” e provave që mbështesin elementin subjektiv të pjesëmarrjes së tërthortë.<sup>27</sup> Sipas Veselit, duke pasur parasysh këtë shpërfillje, në provat e nxjerra nga ZPS-ja nuk ka asgjë që mund të vërtetojë se ai kishte dijeni faktike ose të supozuar për një praktikë të vazhdueshme dhune, urdhra për të sulmuar kundërshtarët apo për veprimtari të tjera konkrete kriminale.<sup>28</sup> Sipas Veselit, ZPS-ja nuk mund të fshihet pas justifikimit procedural se mjaftueshmëria e provave duhet të debatohet në gjykim.<sup>29</sup> Veseli arrin në përfundimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdori kompetencën diskrecionale kur konstatoi se vazhdon të ekzistojë dyshim “i bazuar mirë” në lidhje me Veselin, përkundër mungesës së provave se Veseli mori pjesë personalisht në kryerjen e krimeve, çka është e vetmja provë që mund të mbështesë dijeninë kriminale.<sup>30</sup>

18. ZPS-ja përgjigjet se konstatimet faktike, si ato që mbështesin ekzistencën e “dyshimit të bazuar”, janë paraqitur tashmë në Vendimin e Parë për Paraburgimin dhe nuk ishte e nevojshme të parashtroheshin sërish në Vendimin e Kundërshtuar,

---

<sup>26</sup> Apeli, para. 1 (f. 3), 5.

<sup>27</sup> Apeli, para. 2 (f. 3), që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 26, i cili, nga ana tjetër, i referohet Vendimit të Konfirmimit, para. 460-461, 463, 473. Shih gjithashtu Apeli, para. 3 (f. 3), 5.

<sup>28</sup> Apeli, para. 3 (f. 4). Shih gjithashtu Apeli, para. 4.

<sup>29</sup> Apeli, para. 4.

<sup>30</sup> Apeli para. 1-2 (f. 3), 5.



pasi “nuk ka ndryshuar asgjë që do të kërkonte rivlerësim të konstatimit sipas nenit 41(6)(a)”.<sup>31</sup>

19. ZPS-ja parashtron se, meqenëse Veseli nuk akuzohet si kryes i drejtpërdrejtë i ndonjë krimi dhe, për rrjedhojë, kontestimi i provave lidhur me “pjesëmarrjen personale” të tij nuk është me rëndësi,<sup>32</sup> ishte plotësisht e arsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të arrinte në përfundimin se konstatimi sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit nuk do të ndryshonte edhe nëse provat e përmendura nga Veseli nuk do të merreshin parasysh.<sup>33</sup>

20. Gjithashtu, ZPS-ja thekson se standardi sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit është më i ulët se standardi i dyshimit të bazuar mirë, që është i domosdoshëm për konfirmimin e një aktakuze kundër një të akuzuari, dhe se nuk ekziston asnjë kusht që ZPS-ja të provojë themelësinë e akuzave të saj në kontekstin e këtij rishikimi të paraburgimit.<sup>34</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

21. Paneli rikujton se në kontekstin e kundërshtimeve që kanë lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet vetëm të përcaktojë nëse në kohën e rishikimit të vendimit vazhdon të ekzistojë “dyshim i bazuar se [i akuzuari] ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara”, siç kërkohet nga neni 41(6)(a) i Ligjit. Sikurse vëren me të drejtë Gjykatësi i Procedurës Paraprake, standardi i “dyshimit të bazuar” që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit është më i ulët se standardi i “dyshimit të bazuar mirë” që është i domosdoshëm për konfirmimin e një aktakuze sipas nenit 39(2) të Ligjit.<sup>35</sup>

<sup>31</sup> Përgjigjja, para. 8-9.

<sup>32</sup> Përgjigjja, para. 10.

<sup>33</sup> Përgjigjja, para. 10.

<sup>34</sup> Përgjigjja, para. 9-11. Shih gjithashtu Përgjigjja, poshtëshënimi 15 dhe referencat që përmban.

<sup>35</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 22. Shih gjithashtu Përgjigjja, para. 9. Neni 39(2) i Ligjit përcakton se “kur është i bindur se Prokurori i Specializuar e ka vërtetuar dyshimin e bazuar mirë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmon aktakuzën.” Shih gjithashtu ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-147, Decision on the Defence’s Application for Interim Release, 18 November 2013, para.

22. Në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se “vazhdon të ekzistojë dyshim i bazuar”, duke theksuar se Veseli nuk akuzohet si kryes i drejtpërdrejtë i asnjë prej krimeve të renditura në Vendimin e Konfirmimit, dhe se mungesa e provave në lidhje me pjesëmarrjen e tij të drejtpërdrejtë nuk cenon konstatimin se ekziston dyshim i bazuar mirë se ai mban përgjegjësi penale individuale, sipas formave të ndryshme të përgjegjesisë, për një numër krimesh kundër njerëzimit dhe krimesh lufte.<sup>36</sup>

23. Siç e pranoi vetë Veseli,<sup>37</sup> vendimi për rishikimin e paraburgimit nuk është forumi i duhur për të kundërshtuar konstatimet e bëra në vendimin për konfirmimin e aktakuzës apo provat mbi të cilat mbështeten akuzat e konfirmuara. Në kuadër të nenit 41(6) të Ligjit dhe të marrjes së vendimeve në lidhje me kërkesat për lirim të përkohshëm ose rishikim të paraburgimit, as nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe as nga Paneli i Gjykatës së Apelit nuk mund të pritët të shqyrtojnë themelësinë e akuzave dhe të gjitha provat e paraqitura nga ZPS-ja në përgatitje të gjykimit.<sup>38</sup>

24. Paneli e kupton se Veseli kundërshtoi provat mbi të cilat u bazua Vendimi i Konfirmimit në këtë fazë paraprake të procesit bazuar në materialet e nxjerra sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores pas Vendimit të Parë për Paraburgimin.<sup>39</sup> Në kundërshtim me çka argumenton Veseli,<sup>40</sup> Paneli konstaton se nuk është paraqitur

---

47; ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-548-Red, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Laurent Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 11 July 2013 entitled “Third decision on the review of Laurent Gbagbo’s detention pursuant to article 60(3) of the Rome Statute”, 29 October 2013, para. 38.

<sup>36</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 23, 27, 29.

<sup>37</sup> Parashtrime në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 4.

<sup>38</sup> ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-349, Decision on the “Defence Request for the Interim Release of Dominic Ongwen”, 27 November 2015 (reclassified 24 March 2016), paras 7-13; ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-147, Decision on the Defence’s Application for Interim Release, 18 November 2013, para. 47.

<sup>39</sup> Shih Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 5; Përgjigjja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 6. Shih gjithashtu Apeli, para. 1-4.

<sup>40</sup> Shih Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 3 (f. 3). Është bërë një gabim në vendosjen e numrit të paragrafit në paragrafin 3, i cili është vendosur dy herë. Për të shmangur ndonjë ngatërresë, kur t’i referohet këtij paragrafi, Paneli do të bëjë të ditur numrin e faqes që gjendet në vulën në pjesën e sipërme majtas të faqes në të cilën ndodhet paragrafi përkatës.

asnjë ndryshim i rrethanave dhe se, veç kësaj, një argument i tillë nuk do të përligjete nxjerrjen e një konstatimi të ri të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ekzistencën e dyshimit të bazuar sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit. Kjo për shkak se Veseli nuk akuzohet si kryes i drejtpërdrejtë i asnjërit prej krimeve të përcaktuara në Vendimin e Konfirmimit,<sup>41</sup> dhe kundërshtimi i provave që bën Veseli lidhur me “pjesëmarrjen personale” të tij në krimet - duke aluduar kryerje fizike – është i parëndësishëm.<sup>42</sup> Në këtë aspekt, Paneli thekson se Veseli duket se ngatërron, duke shtrembëruar faktet, konceptet e “pjesëmarrjes personale” ose “sjelljes personale” me ato të “pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë” ose “kryerjes fizike”.<sup>43</sup> Paneli më tej thekson se, në kundërshtim me çka pretendon Veseli, asnjë pretendim apo provë nuk është “shpërfillur” nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Kundërshtuar.<sup>44</sup>

25. Bazuar në sa më lart, Paneli rrëzon argumentet e Veselit të paraqitura në pikën e parë të apelit.

B. PRETENDIMI PËR GABIME NË VLERËSIMIN E NENIT 41(6)(B) TË LIGJIT (PIKA II)

### 1. Parashtrimet e palëve

26. Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se njohja më e plotë e Veselit me provat përmes procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave, shton rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, duke pasur parasysh se asnjë nga provat e nxjerra nga ZPS-ja që nga Vendimi i Parë për Paraburgimin nuk e inkriminon atë, dhe duke qenë se akuzat për “sjellje personale” dhe “pjesëmarrje

<sup>41</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 23. Shih gjithashtu Vendimi i Konfirmimit, para. 460-463, 473-474, 476-478, 480-482, 492-498.

<sup>42</sup> Shih p.sh. ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*, ICTR-95-1-A, Judgment (Reasons), 1 June 2001 (“*Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*”), paras 185-186, 189. *Contra Appeal*, paras 1 (p.3)-5; *Submissions on Detention Review*, paras 3 (p. 3)-26.

<sup>43</sup> Apeli, para. 1-5. Shih p.sh. *Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment*, paras 185-186, 189.

<sup>44</sup> Apeli, para. 1, 3, 5.

personale” nuk u morën parasysh.<sup>45</sup> Sipas tij, këto rreziqe përkundrazi janë zvogëluar.<sup>46</sup>

27. Gjithashtu, Veseli pretendon se konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me aftësinë e Veselit për të ndikuar në procesin gjyqësor apo për ta penguar atë, në veçanti konstatimi se ai vazhdon të ketë ndikim bazuar në “njohuritë, aftësitë dhe kontaktet” që ka fituar në pozitat e tij të mëhershme të lidhura me zbulimin, janë hamendësuese dhe të pabaza.<sup>47</sup> Veseli parashtron se në shtëpinë e tij nuk u gjet asnjë informacion i ndjeshëm dhe konfidencial<sup>48</sup> dhe pretendon se, përkundrazi, ai ka demonstruar besueshmërinë e tij gjatë vizitës nën arrest që bëri në Kosovë ndërkohë që babai i tij ishte i sëmurë rëndë në spital.<sup>49</sup> Veseli arrin në përfundimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdori kompetencën diskrecionale kur nuk vlerësoi saktë faktorët e ndryshëm.<sup>50</sup>

28. ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë u mbështet në faktin se i akuzuari po informohet gradualisht për provat mbi të cilat mbështeten akuzat kundër tij, ndër të tjera edhe për identitetin e dëshmitarëve.<sup>51</sup> Sipas ZPS-së, është brenda kompetencës diskrecionale të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të vlerësojë se si ndikon nxjerrja e mëtejshme e provave në motivet e të akuzuarit dhe, për rrjedhojë, në rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerësoi saktë nxjerrjen graduale të provave.<sup>52</sup>

---

<sup>45</sup> Apeli, para. 6.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Apeli, para. 7.

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Apeli, para. 8.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> Përgjigja, para. 12-13.

<sup>52</sup> Përgjigja, para. 13.

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

29. Fillimisht, Paneli thekson se në këtë pikë të apelit, Veseli paraqet argumente të cilat trajtojnë njëkohësisht rreziqet e ndryshme sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.<sup>53</sup> Duke qenë se përfundimi i arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për vazhdimin e paraburgimit të Veselit nuk bazohet në konstatimet e tij lidhur me rrezikun e arratisjes,<sup>54</sup> Paneli nuk do të trajtojë faktorët që kanë lidhje vetëm me këtë rrezik. Rrjedhimisht, Paneli rikujton se në vlerësimin e tij në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave të Dhomave të Specializuara sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në faktorët e mëposhtëm: (i) gatishmërinë dhe aftësinë e Veselit për të ndërhyrë në çështje që kanë të bëjnë me Dhomat e Specializuara; (ii) njohjen më të plotë me provat mbi të cilat mbështeten akuzat kundër tij si rezultat i procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave; (iii) aftësinë e Veselit për të siguruar mjete për të ndërhyrë në procedurat e Dhomave të Specializuara për shkak të rolit të rëndësishëm që vazhdon të ketë në Kosovë, dhe në veçanti njohurive, aftësive dhe kontakteve që ka fituar në pozitat e mëparshme të lidhura me zbulimin; dhe (iv) atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së.<sup>55</sup>

30. Së pari, në lidhje me argumentet e Veselit për ndikimin e njohjes më të plotë të akuzuarit me provat, Paneli thekson se faktin që “Veseli aktualisht po njihet gjithnjë e më shumë me provat mbi të cilat mbështeten akuzat e rënda kundër tij si rezultat i procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave”, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e vlerësoi si faktor që rrit rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit.<sup>56</sup>

31. Paneli vëren se ndonëse nxjerrja e provave mund të jetë një faktor i rëndësishëm, ajo është vetëm një faktor që mund të merret parasysh në marrjen e

---

<sup>53</sup> Shih Apeli, para. 6-8.

<sup>54</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 46.

<sup>55</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35-36.

<sup>56</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35.

vendimit nëse është i nevojshëm vazhdimi i paraburgimit.<sup>57</sup> Sidoqoftë, ky faktor në vetvete nuk mjafton për të përligjur refuzimin e lirit të përkohshëm. Paneli rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi këtë faktor së bashku me faktorë të tjerë për të përcaktuar ekzistencën e rrezikut të pengimit.<sup>58</sup>

32. Gjithashtu, Paneli vë në dukje se ndërmjet nxjerrjes së Vendimit të Parë për Paraburgimin më 22 janar 2021 dhe nxjerrjes së Vendimit të Kundërshtuar, Mbrojtjes iu vunë në dispozicion 444 prova fajësuese.<sup>59</sup>

33. Për këto arsye, Veseli nuk ka vërtetuar se ishte i paarsyeshëm përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se njohja më e plotë e Veselit me provat mbi të cilat mbështeten akuzat kundër tij, marrë së bashku me faktorë të tjerë, shton rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit.

34. Për sa i takon argumentit të Veselit lidhur me ndikimin e tij, Paneli vëren se konstatimi i kontestuar se Veseli vazhdon të ketë ndikim në sajë të “njohurive, aftësive dhe kontakteve” që ai “ka fituar në pozitat e mëparshme të lidhura me zbulimin”<sup>60</sup> ishte vërtetuar në Vendimin e Parë lidhur me Lirimin e Përkohshëm në bazë të elementeve dhe provave të ndryshme.<sup>61</sup> Po ashtu, argumentet e Veselit lidhur me Driton Lajçin, siç e pranon edhe ai vetë, tashmë janë trajtuar - dhe përfundimi i nxjerrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake është konfirmuar - nga Paneli i Apelit.<sup>62</sup> Paneli

<sup>57</sup> ICC/GJPN, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-278-Red, Public redacted version of Judgment on the appeal of Mr Laurent Koudou Gbagbo against the decision of Pre-Trial Chamber I of 13 July 2012 entitled “Decision on the ‘Requête de la Défense demandant la mise en liberté provisoire du président Gbagbo’”, 26 October 2012 (“*Gbagbo* Appeal Judgment on Interim Release”), para. 65.

<sup>58</sup> Shih më lart, para. 29. Shih gjithashtu Vendimi i Kundërshtuar, para. 35-36.

<sup>59</sup> Kjo shifër është rezultat i nxjerrjes së dy paketave me materiale sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores dhe nxjerrjes së shtatë paketave me materiale sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, që përmbajnë gjithsej 444 prova fajësuese dhe përfshijnë gjithsej 7850 faqe. Në të përfshihen të gjitha materialet që ndodhen brenda këtyre paketave dhe, për rrjedhojë, në këtë shifër nuk llogaritet informacioni që përsëritet për shkak të përfshirjes së versioneve të përkthyer, redaktuara dhe/ose të rishikuara të disa materialeve brenda këtyre paketave me materiale të nxjerra.

<sup>60</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 35. Shih gjithashtu Vendimi i Kundërshtuar, para. 48-49.

<sup>61</sup> Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 32, 34, 39, 43.

<sup>62</sup> Vendimi i Apelit të Veselit, para. 36-40. Shih Apeli, para. 7.

konstaton se Veseli thjesht nuk pajtohet me vlerësimin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake u bën faktorëve të ndryshëm<sup>63</sup> dhe vetëm përsërit argumentet e pafrytshme të paraqitura para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të cilat nuk ndikojnë në vendimin e tij të mëhershëm. Veseli nuk identifikon asnjë gabim të qartë në rrezimin e argumenteve të tilla nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>64</sup>Rrjedhimisht, Paneli nuk gjykon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur u mbështet në këta faktorë.

35. Sipas mendimit të Panelit, argumenti i Veselit se rasti i tij është “i dallueshëm” për faktin se nuk ka prova që [REDAKTUAR], është i parëndësishëm, duke pasur parasysh se konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me rrezikun e pengimit që paraqet Veseli bazohet në faktorë të tjerë (personalë dhe kontekstualë).<sup>65</sup> Veseli nuk tregon pse ishte e paarsyeshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të arrinte në konstatimin që nxori në lidhje me rrezikun e pengimit.<sup>66</sup> Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë argumentin e Veselit.

36. Në vijim, Paneli do të trajtojë argumentet e Veselit në lidhje me besueshmërinë që ai pretendon se ka demonstruar gjatë vizitës nën arrest që së fundmi kreu në Kosovë.<sup>67</sup> Paneli gjykon se Veseli nuk demonstroi se si gaboi Gjykatësi i Procedurës Paraprake kur vlerësoi lidhjen mes sjelljes së tij gjatë vizitës nën arrest dhe rrezikut të pengimit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit. Paneli rikujton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi shprehimisht dhe gjerësisht këtë argument në lidhje me lirimin e përkohshëm të Veselit, por konstatoi se, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të vizitave nën arrest dhe kushtet e rrepta të vendosura gjatë këtij lirimi të përkohshëm,

---

<sup>63</sup> Shih p.sh. Vendimi i Apelit të Veselit, para. 47; Vendimi i Apelit të Gucatit, para. 64.

<sup>64</sup> Shih p.sh. Vendimi i Apelit të Thaçit, para. 60.

<sup>65</sup> Shih Vendimi i Kundërshtuar, para. 35-36. Apeli, para. 7.

<sup>66</sup> Shih Apeli, para. 7.

<sup>67</sup> Apeli, para. 8. Shih gjithashtu F00271, Version i Redaktuar Publik i Vendimit në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare, 11 maj 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021) (“Vendimi në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Veselit”).

sjellja e Veselit dhe familjes së tij nuk ishte vendimtare për vendimin e tij.<sup>68</sup> Paneli nuk konstaton asnjë gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

37. Duke pasur parasysh se Paneli nuk ka konstatuar asnjë gabim në përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se ekzistonte rreziku i pengimit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, çka e bënte të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit, nuk është e nevojshme që Paneli të trajtojë pretendimet për gabime lidhur me nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.<sup>69</sup> Rrjedhimisht, Paneli rrëzon pikën e dytë të Apelit të Veselit.

38. Sidoqoftë, Paneli duhet të shqyrtojë nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se Kushtet e Propozuara nuk mund të zvogëlonin rrezikun e pengimit të procesit.

#### C. PRETENDIMI PËR GABIME NË VLERËSIMIN E KUSHTEVE TË LIRIMIT (PIKAT III) DHE IV))

##### 1. Parashtrimet e palëve

39. Së pari, Veseli parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor dhe shpërdori kompetencën diskrecionale të tij “kur vendosi një standard të pasaktë dhe jashtëzakonisht të lartë për zvogëlimin e rrezikut, i cili nuk mund të përmbushet me asnjë kusht të arsyeshëm lirimi”.<sup>70</sup> Veseli argumenton se mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në “përvojën në zbulim” të Veselit për të përligjur konstatimet e tij në lidhje me rrezikun që Veseli t’i përcillte mesazhe të fshehta një personi të tretë, është jo vetëm e pabazë, por edhe arbitrare.<sup>71</sup> Gjithashtu, Veseli argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej ta kishte konsideruar besueshmërinë e Veselit

---

<sup>68</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 50. Shih Vendimi në lidhje me Lirimin e Përkohshëm të Veselit, para. 18-19, 25.

<sup>69</sup> Shih p.sh. Vendimi i Apelit të Veselit, para. 53.

<sup>70</sup> Apeli, para. 3(iii) (f. 3), 10.

<sup>71</sup> Apeli, para. 9.



si faktor lehtësues, veçanërisht faktin se ai nuk e shfrytëzoi vizitën e tij nën arrest për të komunikuar me palë të treta të paautorizuara.<sup>72</sup>

40. Së dyti, Veseli pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e kishte për detyrë të shqyrtonte nëse Kushtet e Propozuara mund të zbatoheshin.<sup>73</sup> Në veçanti, Veseli argumenton se, pasi kishte konstatuar se garancitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës (“Drejtori i Policisë”) ishin shumë “të përgjithshme” dhe se ishte e nevojshme që ai të jepte një “përgjigje të hollësishme”, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhej të shpërfillte kërkesën e Mbrojtjes për të urdhëruar dhënien e informacioneve të mëtejshme nga Drejtori i Policisë<sup>74</sup> dhe duhej ta kishte udhëzuar Drejtorin e Policisë që këtë informacion ta jepte, sipas nevojës në seancë gojore.<sup>75</sup> Rrjedhimisht, Veseli kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit t’ia kthejë çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rishqyrtim, pasi të ketë urdhëruar Drejtorin e Policisë që të trajtojë zbatueshmërinë e Kushteve të Propozuara.<sup>76</sup>

41. Në lidhje me pikën e parë, ZPS-ja përgjigjet se Veseli thjesht nuk pajtohet me vlerësimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të Kushteve të Propozuara përkundrejt rreziqeve, dhe se ai nuk identifikon asnjë gabim.<sup>77</sup> Sipas ZPS-së, Vendimi i Kundërshtuar përmban arsye të hollësishme se pse kushtet ishin të pamjaftueshme dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në kryerjen e vlerësimit të tij, mori parasysh edhe kushtet e reja të propozuara nga Mbrojtja.<sup>78</sup> Sa i përket përvojës në zbulim të Veselit, ZPS-ja parashton se ajo përbën një faktor që rrit rrezikun që paraqet konkretisht Veseli.<sup>79</sup>

---

<sup>72</sup> Apeli, para. 10.

<sup>73</sup> Apeli, para. 12.

<sup>74</sup> Apeli, para. 11.

<sup>75</sup> Apeli, para. 12.

<sup>76</sup> Apeli, para. 13.

<sup>77</sup> Përgjigjja, para. 15.

<sup>78</sup> Po aty.

<sup>79</sup> Po aty.

42. Lidhur me pikën e dytë, ZPS-ja parashtron se Paneli “nuk është i detyruar të vlerësojë gatishmërinë dhe aftësinë e një shteti për zbatimin e kushteve” nëse asnjë kusht nuk mund t’i zvogëlojë rreziqet e identifikuar.<sup>80</sup> Sipas ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithsesi vlerësoi siç duhet garancitë e Drejtorit të Policisë. Gjithashtu, ZPS-ja i referohet një vendimi të mëhershëm, në të cilin Paneli i Gjykatës së Apelit mbështeti konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se garancitë e mjegullta të Drejtorit të Policisë ishin të pamjaftueshme dhe argumenton se garancitë e reja, edhe nëse do të ishin shprehur më qartë, do të ishin të pamjaftueshme për të trajtuar rreziqet që paraqet Veseli nëse lirohet.<sup>81</sup> ZPS-ja parashtron se “është në kompetencën e brendaqenësishme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të kërkojë sqarime të mëtejshme në lidhje me garancitë e shtetit”, dhe se pamjaftueshmëria e garancive bëri që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të mos detyrohej ta bënte këtë.<sup>82</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se as Kushtet e Propozuara dhe as kushte të tjera shtesë që mund të vendoste, nuk mund të zvogëlonin mjaftueshëm rrezikun e pengimit të ecurisë së procedurave të Dhomave të Specializuara dhe rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera që paraqet Veseli.<sup>83</sup> Në veçanti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se Kushtet e Propozuara nuk do të parandalonin bisedat e pamonitoruara ndërmjet Veselit dhe anëtarëve të familjes apo vizitorëve të miratuar, të cilët, edhe nëse do të dorëzonin pajisjet e tyre dhe do të pajtoheshin me monitorimin e mëpasshëm të pajisjeve të tyre, sërish do të ishin në gjendje të përcillnin mesazhe “në një numër mënyrash”.<sup>84</sup> Për shembull, Kushtet e Propozuara nuk do ta pengonin Veselin që t’u kërkonte vizitorëve të tij që t’i përcillnin mesazhet me gojë

---

<sup>80</sup> Përgjigjja, para. 16, që i referohet *Gbagbo* Appeal Judgment on Interim Release, para. 80.

<sup>81</sup> Përgjigjja, para. 16.

<sup>82</sup> Përgjigjja, para. 17.

<sup>83</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 47-51.

<sup>84</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 48.

ose duke përdorur pajisje që i përkasin një personi të tretë.<sup>85</sup> Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, çdo kusht tjetër, si monitorimi i vizitave nga policia e Kosovës, nuk do të zvogëlonte mjaftueshmërisht rrezikun, dhe komunikimet e Veselit do të mund të kufizoheshin dhe monitoroheshin mjaftueshëm vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.<sup>86</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se përgjigjja e Drejtorit të Policisë nuk trajtonte konkretisht nëse Kushtet e Propozuara mund të zbatoheshin me efektshmëri dhe, nëse po, cilat ishin masat që do të merreshin, duke pohuar se fakti që Kushtet e Propozuara nuk do të parandalonin bisedat e pamonitoruara dhe se për to do të duhej miratimi i masave që kërkojnë burime mjaft të mëdha, “e bën edhe më të nevojshme dhënien e një përgjigjeje të hollësishme nga drejtori i policisë”.<sup>87</sup> Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se sjelljes së Veselit dhe familjes së tij gjatë vizitës nën arrest i duhej dhënë rëndësi e kufizuar.<sup>88</sup>

44. Duke pasur parasysh konstatimet e veta në lidhje me pikën e dytë të Apelit të Veselit, Paneli nuk do të trajtojë argumentet e Veselit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të kishte marrë parasysh se besueshmëria e Veselit, që pretendohet se u vërtetua nga sjellja e tij e mirë gjatë vizitës nën arrest, zvogëlon rrezikun e “instrumentalizimit të palës së tretë”.<sup>89</sup>

45. Paneli i Gjykatës së Apelit do të trajtojë parashtrimin e Veselit se, për Gjykatësin e Procedurës Paraprake, nuk ka asnjë kusht që do të mund të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet.<sup>90</sup> Paneli vëren se masat e përfshira në Kushtet e Propozuara të Veselit janë

---

<sup>85</sup> Po aty.

<sup>86</sup> Po aty.

<sup>87</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 49.

<sup>88</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 50.

<sup>89</sup> Shih më lart, para. 36. Shih Apeli, para. 10. Shih gjithashtu Apeli, para. 9.

<sup>90</sup> Apeli, para. 3(iii) (f. 3), para. 10.

shumë të gjera.<sup>91</sup> Për shembull, masa të tilla si ndalimi i çdo pajisjeje telekomunikimi ose të lidhur me internetin brenda pronës së Veselit, dorëzimi i çdo pajisjeje të tillë nga vizitorët e miratuar paraprakisht përpara kryerjes së vizitës dhe monitorimi i mëposhëm i pajisjeve të komunikimit të vizitorëve për aq kohë sa zgjat lirimi i përkohshëm i Veselit, mund të parandalojnë përdorimin prej Veselit të pajisjeve elektronike që u përkasin anëtarëve të familjes apo të njohurve të tij.

46. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në “pozitën e rëndësishme” dhe në “aftësitë e caktuara për shkak të përvojës së tij në zbulim” kur konstatoi se “ekziston mundësia reale që z. Veseli mund t’i kërkojë dikujt që t’i përcjellë porositë me gojë ose të përdorë pajisje që i përkasin një personi të tretë për ta bërë këtë”.<sup>92</sup> Ndonëse Veseli e etiketon këtë mbështetje si “arbitrare”<sup>93</sup> dhe argumenton se këtij konstatimi i mungon arsyetimi, Paneli gjykon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake dha arsyetimin e duhur. Në rastin konkret, Paneli rikujton se Veseli ishte anëtar themelues i UÇK-së dhe i Shtabit të Përgjithshëm të saj, ku mbajti poste me pushtet, ndër to edhe atë të shefit të shërbimit të zbulimit të UÇK-së.<sup>94</sup> Paneli gjykon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, si pjesë e vlerësimit të tij, mund të mbështetej në këta faktorë që kanë lidhje konkrete me të akuzuarin.

47. Paneli rikujton se komunikimet dhe vizitat në paraburgim janë objekt i monitorimit deri në një farë mase në mjedisin e kontrolluar të objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në përputhje me kornizën ligjore të zbatueshme.<sup>95</sup>

---

<sup>91</sup> F00001/A02, Shtojca 2 e Apelit të Mbrojtjes së Veselit ndaj Vendimit KSC-BC-2020-06/F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit), 15 korrik 2021 (konfidenciale) (“Shtojca 2 e Apelit”), f. 3-6. I njëjti dokument i është dorëzuar edhe Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Shih F00341/A03, Shtojca 3 e Parashtrimeve të Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, 7 qershor 2021 (konfidenciale), f. 2-5.

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> Apeli, para. 9.

<sup>94</sup> Shih p.sh. Vendimi mbi Arrestimin dhe Paraburgimin, para. 33. Shih gjithashtu Vendimi i Apelit të Veselit, para. 40.

<sup>95</sup> Shih veçanërisht Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative në lidhje me të Paraburgosurit, Vizitat dhe Komunikimet, KSC-BD- 09/Rev1/2020, 23 shtator 2020 (“Udhëzuesi i Punës”). Në objektin e paraburgimit vizitat që u bëhen të paraburgosurve kryhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të KSC-BC-2020-06

Sidoqoftë, çështja nëse i njëjti nivel i monitorimit të bisedave mund të zbatohet jashtë parburgimit, mbetet për t'u përcaktuar.

48. Paneli vëren se Veseli në fakt propozoi një listë të detajuar të kushteve, të cilat, teorikisht, mund të kufizojnë dhe monitorojnë komunikimet e tij. Sidoqoftë, Paneli thekson se ende duhet të vlerësohet nëse masa të tilla mund të zbatohen me efektshmëri. Në këtë aspekt, Paneli konstaton se gatishmëria dhe aftësia e policisë së Kosovës për të zbatuar kushtet e propozuara mund të ndihmojë në zvogëlimin e rreziqeve të identifikuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>96</sup> Për rrjedhojë, paneli kompetent duhet të shqyrtojë nëse, sipas rastit, garancitë që janë dhënë mund të zvogëlojnë mjaftueshërisht rreziqet.<sup>97</sup> Një shqyrtim i tillë duhet të bëhet rast pas rasti. Paneli gjykon se duke pasur parasysh listën e gjerë të kushteve të propozuara nga Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka mund të nxjerrë përfundimin se asnjë prej këtyre kushteve nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet e identifikuara, pa kërkuar informacion të mëtejshëm në lidhje me zbatueshmërinë e këtyre masave.

49. Rrjedhimisht, në lidhje me garancitë e Policisë së Kosovës, Paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se për shkak të natyrës së saj të përgjithshme,<sup>98</sup> përgjigjja e Drejtorit të Policisë në vetvete nuk mund të konsiderohet se përbën pajtim për të garantuar zbatimin e Kushteve të Propozuara.<sup>99</sup> Po ashtu, Paneli pajtohet me

---

oficerëve të parburgimit dhe ata mund të urdhërojnë që të bëhet incizimi, dëgjimi, përmbledhja dhe transkriptimi i vizitave me vizitorë të caktuar (Neni 15 i Udhëzuesit të Punës). Komunikimet e pamonitoruara në fakt janë rreptësisht të kufizuara. Për shembull, të akuzuarve u lejohen "vizita private" të pamonitoruara por vetëm për anëtarë të caktuar të familjes së ngushtë dhe për periudha të kufizuara kohe (Neni 24 i Udhëzuesit të Punës).

<sup>96</sup> Shih p.sh. ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-560, Judgment on the appeal of Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo against the decision of Pre-Trial Chamber II of 17 March 2014 entitled "Decision on the 'Requête de mise en liberté' submitted by the Defence for Jean-Jacques Mangenda", 11 July 2014, para. 128. Shih gjithashtu *Gbagbo* Appeal Judgment on Interim Release, paras 77-79.

<sup>97</sup> Përgjigjja, para. 16.

<sup>98</sup> Shih Shtojca 2 e Apelit, f. 7-8.

<sup>99</sup> Shih Vendimi i Kundërshtuar, para. 49. Kundërpërgjigjja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Parburgimit, para. 10.

Gjykatësin e Procedurës Paraprake se, duke pasur parasysh shkallën e hollësive të pyetjeve të parashtruara nga mbrojtësi i Veselit,<sup>100</sup> mund të pritej që drejtori i policisë të jepte një përgjigje më konkrete, të mbështetur në dokumentacionin përkatës si dhe masat konkrete që mund të ndërmerreshin, por një përgjigje e tillë nuk u dha.<sup>101</sup> Në këto rrethana, Paneli konstaton se, ndonëse garancitë e Policisë së Kosovës duket se demonstrojnë vullnetin/gatishmërinë e saj për të garantuar zbatimin e kushteve të propozuara, duke mbajtur parasysh informacionin e paktë në dispozicion, nuk është e mundshme të vlerësohen kapaciteti dhe burimet faktike të policisë së Kosovës për t'i vënë në zbatim këto masa.

50. Paneli vëren se situata aktuale ndryshon nga situata që Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrtoi në Vendimin e Apelit të Veselit, në të cilin konstatoi se “do të kishte qenë në kompetencën diskreionale të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të kërkonte sqarime të tilla dhe të dëgjonte parashtrimet përkatëse përpara se të merrte vendimin, megjithëse, [...], ai nuk ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë”.<sup>102</sup> Në fakt, kjo është hera e dytë që mbrojtësi i Veselit kërkon vërejtjet e Drejtorit të Policisë – këtë herë duke i kërkuar të konfirmojë konkretisht aftësinë e Policisë së Kosovës për të garantuar zbatimin e 11 kushteve të përcaktuara dhe duke e informuar se Dhomat e Specializuara e konsideruan përgjigjen e tij të mëhershme si jo mjaftueshëm të hollësishme.<sup>103</sup> Sidoqoftë, kjo është hera e dytë që Veseli merr të njëjtën përgjigje të përgjithshme dhe të mjegullt.<sup>104</sup> Kjo dëshmon për përpjekjet e përsëritura e të pasuksesshme të Mbrojtjes për të mbledhur informacionin e hollësishëm përkatës. Pas kësaj, Veseli i paraqiti Gjykatësit të Procedurës Paraprake parashtrime lidhur me Kushtet e Propozuara dhe çështjen e zbatueshmërisë së tyre, dhe kërkoi shprehimisht nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të nxirrte një urdhër me anë të cilit t'i

---

<sup>100</sup> Shtojca 2 e Apelit, f. 3-6.

<sup>101</sup> Shtojca 2 e Apelit, f. 7-8. Shih gjithashtu Vendimi i Kundërshtuar, para. 49.

<sup>102</sup> Vendimi i Apelit të Veselit, para. 74 (poshtëshënimet e brendshme janë hequr).

<sup>103</sup> Shtojca 2 e Apelit, f. 3-6.

<sup>104</sup> Shtojca 2 e Apelit, f. 7-8; F00174/A11, Shtojca 11 e Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kërkesën e për Lirim të Përkohshëm të Kadri Veselit, 13 janar 2021, f. 1.

kërkonte Drejtorit të Policisë ose ta udhëzonte atë që të jepte më shumë informacion, në rast se Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të konstatonte se letra ishte e pamjaftueshme.<sup>105</sup>

51. Paneli konstaton se, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykoi se përgjigjja e Policisë së Kosovës nuk ishte mjaftueshmërisht bindëse, ai duhet t'i ishte drejtuar Drejtorit të Policisë për të marrë përgjigjen e hollësishme që sipas konstatimit të tij mungonte, sidomos pasi që Veseli ia kërkoi shprehimisht ta bënte një gjë të tillë<sup>106</sup> dhe përgjigjja e Drejtorit të Policisë lë të kuptohet aftësinë e Policisë së Kosovës për t'i vënë në zbatim kushtet.<sup>107</sup> Paneli rikujton se kërkimi i këtij informacioni përfshihet në kompetencat diskrecionale të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ia jep neni 39(13) të Ligjit për çështje që kanë të bëjnë me paraburgimin, në varësi të rrethanave të rastit.<sup>108</sup> Gjithashtu, Paneli vëren se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka dhënë arsye pse nuk urdhëroi Drejtorin e Policisë të jepte përgjigje të hollësishme, pavarësisht se pranoi nevojën për një përgjigje të tillë.<sup>109</sup>

52. Rrjedhimisht, në bazë të rrethanave konkrete të rastit, Paneli e vlerëson me vend parashtrimin e Veselit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake shpërdori kompetencën e vet diskrecionale kur nxori përfundimin se asnjë nga Kushtet e Propozuara dhe asnjë kusht shtesë nuk mund t'i zvogëlonte rreziqet e identifikuar, pa kërkuar fillimisht parashtrime shtesë nga Drejtori i Policisë. Paneli konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk e bëri këtë, duke qenë se ky

---

<sup>105</sup> Shih Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 35-37. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 10-11.

<sup>106</sup> Parashtrimet mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 37; Kundërpërgjigjja ndaj Parashtrimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 11.

<sup>107</sup> Shtojca 2 e Apelit, f. 7-8: [REDAKTUAR] (theksimi i shtuar).

<sup>108</sup> KSC-BC-2020-04, F00005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit në lidhje me Lirimimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 20 gusht 2021), para. 60. Shih gjithashtu F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 86.

<sup>109</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 49.

informacion do t'i kishte mundësuar të vlerësonte nëse Policia e Kosovës mund t'i zbatojë apo jo efektivisht këto masa, ndër të cilat edhe masat e sugjeruara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, si për shembull monitorimi i vizitave. Një informacion më i saktë i këtij lloji do t'i siguronte Gjykatësit të Procedurës Paraprake një bazë faktike më të plotë dhe më të fortë për të vlerësuar realizueshmërinë e kushteve të tilla, sigurisht pa paragjykuar rezultatin e vendimit përfundimtar mbi këto aspekte.

53. Bazuar në sa më lart, Paneli i Gjykatës së Apelit miraton pikën e katërt të Apelit të Veselit dhe ia kthen çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të vlerësuar nëse Policia e Kosovës është në gjendje t'i zbatojë me efektshmëri Kushtet e Propozuara ose çdo kusht tjetër që Gjykatësi i Procedurës Paraprake e përcakton si të nevojshëm për të zvogëluar rreziqet e identifikuar.

## V. VENDIM

54. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** pikën e katërt të Apelit të Veselit;

**IA KTHEN** çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm në përputhje me paragrafët 51-53 të këtij Vendimi;

**RRËZON** të gjitha aspektet e tjera të Apelit (pikën e parë, të dytë dhe të tretë të Apelit të Veselit); dhe

**URDHËRON** palët që brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim, të dorëzojnë për protokollim versionet e redaktuara publike të Apelit dhe Përgjigjes ose të bëjnë të ditur, nëpërmjet një parashtrimi, nëse këto parashtrime mund të riklasifikohen si publike.



/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E premte, 1 tetor 2021

Në Hagë, Holandë.